VENDIM
Nr. 739, datë 2.10.2026

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIM I RRUGËS ELBASAN – QAFËTHANË (FAZA VI)"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Zgjerim i rrugës Elbasan–Qafëthanë (faza VI)".
2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", "truall", "pemëtore" dhe "ndërtesë", me një vlerë të përgjithshme prej 140 341 858.9 lekë (njëqind e dyzet milionë e treqind e dyzet e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë pikë nëntë) lekësh.
4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 140 341 858.9 lekë (njëqind e dyzet milionë e treqind e dyzet e një mijë e tetëqind e pesëdhjetë e tetë pikë nëntë) lekësh, përballohet nga buxheti i shtetit, llogaria "Fondi i shpronësimeve", në Bankën e Shqipërisë.
5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.
7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Agjencisë Shtetërore për Shpronësimin.
8. Agjencia Shtetërore për Shpronësimin kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.
9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.
10. Autoriteti Rrugor Shqiptar, pas miratimit të këtij vendimi, aplikon menjëherë pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, e cila brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të vendimit, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron aktin e kalimit të pronësisë në favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të aktit të kalimit të pronësisë favor të shtetit, në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Autoritetin Rrugor Shqiptar për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.
12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Elbasan, Agjencia

Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Elbasan për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Albana Koçiu

LISTA EMËRORE E PRONARËVE, PASURITË E PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I RRUGËS ELBASAN–QAFËTHANË (FAZA VI)"

Nr.	Pronari			Adresa	Të dhënat kadastrale (sipas kartelës së pasurisë nga DVASHK – Elbasan)						VLERËSIMET PER SHPRONËSIM											Vlera totale	Shënime
											Vlerësimi për shpronësim për llojin e pasurisë "arë" dhe "pemëtore"			Vlerësimi për shpronësim sipas llojit të pasurisë "truall"			Vlerësimi për ndërtesat objekt banimi			Sipërfaqe e shpronësimit objekt sociale-ekonomik (m^2)	Vlerësimi për ndërtesa socio-ekonomike (vlerësuar me preventiv/situacion punimesh)		
	Emri	Atësia	Mbiemri	Rrethi	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale e pasurisë	Truall	Ndërtesë	Sip. (m2)	Cmimi (lekë/m^2)	Vlera (leke)	Sip. (m^2)	Cmimi (lekë/m^2)	Vlera (lekë)	Sip. (m^2)	Cmimi (lekë/m^2)	Vlera (leke)				
1	Ahmet	Qamil	Roçi	Tiranë	1063	88/2	Truall	270.00	270.00	100.03				270.00	221	59,670.00	100.03	32,695	3,270,480.85			3,330,150.85	
2	Sami	Sabri	Alcani	Tiranë	1063	88/3	Truall	270.00	270.00	100.03				270.00	221	59,670.00	100.03	32,695	3,270,480.85			3,330,150.85	
3	Idajet	Breshan	Hajdini	Tiranë	1063	525/1	Truall	127.00	127.00	127.00				63.00	221	13,923.00				198.00	27,524,797.60	27,538,720.60	
4	Idajet	Breshan	Hajdini	Tiranë	1063	525/2	Truall	523.00	523.00					469.00	221	103,649.00						103,649.00	
5	Gentjan	Shyqyri	Gjoshi	Tiranë	1063	604/16	Truall	277.70	277.70	277.70				277.70	221	61,371.70				523.30	44,170,754.60	44,232,126.30	
6	Avni Vera	Sulejman Halil	Bozhiqi Bozhiqi	Librazhd	1063	100/15	Truall	480.30	480.30	225.50				401.00	221	88,621.00				225.50	13,588,361.00	13,676,982.00	
7	Sanije Fatmir	Xheladin Halil	Bozhiqi Bozhiqi	Librazhd	1063	602/5-N	Ndërtesë	96.70		96.70							96.70	32,695	3,161,606.50			3,161,606.50	
8	Fatmir	Hilil	Bozhiqi	Librazhd	1063	602/5	Pemëtore	2,390.00			1,115.00	174	194,010.00									194,010.00	
9	Ferit	Rexhep	Blloshmi	Librazhd	1063	88/1	Truall	265.00	265.00	78.52				265.00	221	58,565.00				78.52	4,800,755.90	4,859,320.90	
10	Gezim Ruzhdije	Ramazan Rapush	Qoshku Qoshku	Librazhd	1063	146/9-N	Ndërtesë	146.80	-	146.80							265.10	32,695	8,667,444.50			8,667,444.50	
11	Gezim	Ramazan	Qoshku	Librazhd	1063	146/9	Arë + truall	1,800.00	300.00	0.00	1,193.00	174	207,582.00	300.00	221	66,300.00						273,882.00	
12	Hamide	Ali	Perreja	Librazhd	1063	142/3	Truall	500.00	500.00	264.30										620.50	30,973,815.40	30,973,815.40	
VLERA TOTALE																						**140,341,858.90**	